



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtinë, më 10.04.2020

Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prishtinës në bazë të legjislacionit në fuqi hapë:



THIRRJE PUBLIKE (#rrinshpi me neve)

Për të gjithë **individët**, programi i punës i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, sportit, inovacionit dhe edukimit që të aplikojnë për mbështetje financiare.

- 1. #rrinshpi me neve** është koncept ide që ka për qëllim realizimin e aktiviteteve kulturore, sportive, inovative dhe edukative që do të shfaqen në një nga emisionet televizive, platformat online dhe në rrjetet sociale të Komunës së Prishtinës gjatë periudhës së pandemisë **Covid19**. Aktivitetet financohen dhe xhirohen nga Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me partnerët dhe me përfituesit eventual.
- 2.** Për të aplikuar në këtë thirrje kanë të drejtë profesionistë nga fusha e kulturës, sportit, inovacionit dhe edukimit. Në këtë thirrje kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë individët, të cilët kanë ide të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve/performancave që mund të realizohen më së shumti tre (3) persona.

Llojet e sugjeruara të aktiviteteve (mund të ketë edhe të tjera):

#rriNshpi e ngo live - Performanca muzikore të bendeve dhe kantautorëve;

#rriNshpi e kce - Performanca muzikore të DJ;

#rriNshpi e relaksohu - Yoga seancë apo seancë meditimi;

#rriNshpi e aktivizoj muskujt - Yoga seancë apo GYM seancë;

#rriNshpi e msoje naj recept - Seancë gatimi;

#rriNshpi e thellohu - Tregime, vargje, poezi apo recitim;

#rriNshpi e llaf llaf llaf - Stand up;

*Nëse keni ndonjë ide/propozim tjetër, ju lutem që ta shkruani në email.**

3. Vlera e përgjithshme e planifikuar e thirrjes është 30.000€ (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **100€ (Euro)**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **1,000€ (euro)**.

*Në email duhet të specifikoni apo shkruani shumën që kërkonit për realizim të aktivitetit/performancës.**

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga dt. **10.04.2020** deri më **17.04.2020**

4. Kriteret dhe mënyra e aplikimit për pjesëmarrje në thirjen publike të subvencioneve #rriNshpi me neve:

- Të shkruhet një koncept ide rreth aktivitetit me 100-500 karaktere.
- Subjekti në email duhet të shkruhet **#rriNshpi me neve_Emri dhe mbiemri_Titulli i projektit_Fusha e aplikimit)**
- Dokumentet të cilat duhet të bashkangjiten në email:

Kopja e letërnjoftimit/pasaportës apo dokument tjetër identifikues valid;

Vërtetimi/konfirmimi i llogarisë bankare/dhe nje rezume kreative.

Projekti bashkë me dokumentet duhet të dërgohen në emailin:
kultura.pr@rks-gov.net, jo më larg se data 17.04.2020.

5. Aktiviteti mund të realizohet me jo më shumë se tre (3) persona.

Kohëzgjatja e aktiviteteve: 45-75 minuta.

Realizimi (xhirimi) i aktivitetit do të bëhet në një ambient të mbyllur duke mbajtur distancë dhe duke respektuar të gjitha rekomandimet e insitucioneve shëndetësore për parandalim të Covid19.

Realizimi (xhirimi) i aktivitetit do të bëhet nga Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me partnerët potencial.

6. Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në individ tjetër, OJQ apo biznes, apo cilido variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njejta vlenë edhe për ndryshim të xhirollogarisë.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: kultura.pr@rks-gov.net, dhe në numrin e telefonit +383 44989764.

Të gjitha dokumentet që nxirren me afat të shkurtër nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj!

Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më 17 Prill, në orën 23:59, përmes emailit kultura.pr@rks-gov.net: